

C.nr.433/12

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti i përgjithshëm –
Divizioni Civil, gjyqtari gjyqtari Enes Mehmeti me bashkëpunëtorin profesional Alban
Beqiri, në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] [REDACTED]
[REDACTED], të cilën e përfaqëson [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurit, [REDACTED]
[REDACTED] nga Shtimja rr.' [REDACTED]' të cilin e përfaqëson [REDACTED] me autorizim, për
pagimin e borxhit vlera e kontestit 5.478,09 € pas seancës publike të mbajtur më
11.02.2015, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në prezencën e të paditurit,
mori këtë:

AKT GJYKIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses, [REDACTED]
[REDACTED]

DETYROHET i padituri [REDACTED], që paditëses t'i paguajë shumën prej
5.478,09 €, në emër të borxhit të cilin e ka krijuar në rastin e shpenzimit të energjisë
elektrike, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 100 €, të gjitha në
afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit
me dhunë.

Arsyetim

Paditësja, [REDACTED] [REDACTED], në këtë
Gjykatë me dt.17.07.2012, ka ushtruar propozim për përmbarrim ndaj të paditurve
[REDACTED] dhe [REDACTED] si debitor për pagesën e borxhit në lartësi prej
7.037,82 €, në bazë të dokumentit autentik duke provuar me faturën nr.DFE-[REDACTED], të
dt.20.05.2012.

Kjo gjykatë me aktvendim E.nr.1133/12, të dt.09.08.2012, ka lejuar përmbarrimin
ndaj të paditurve si debitor, i padituri i parë në aktvendim mbi lejjimin e përmbarrimit në
afatin e paraparë ligjor me dt.22.08.2012, ka parashtruar kundërshtim me arsyetim se
borxhin në fjal nuk e kam krijuar unë por [REDACTED] i cili ka qenë me qira në lokal dhe
i njëjti nuk e ka kryer obligimin ndaj paditëses për energjinë e shpenzuar.

Përfaqësuesi i paditëses 11.02.2015, ka tërhequr dorë nga paditësi i dytë [REDACTED], me arsyetim se është e njohur botërisht se pas 12.qershorit 1999 në Shtime, nuk ka jetuar pjesëtar të komuniteti serb ku dhe realisht nuk ka pasur mundësi të ketë krijuar shpenzim të energjisë elektrike, kurse ndaj të paditurit të parë [REDACTED], ka bërë precizimin e kërkesë padisë nga shuma 7.037.82€ e ka zvogëluar në shumë prej 5,478.09€, në emër të shpenzimeve elektrike të cilat i ka krijuar i padituri, dhe ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon padinë dhe kërkesë padinë e precizuar si të bazuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese.

I autorizuar i të paditurit [REDACTED] në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e kundërshton padinë dhe kërkesë padinë e paditëses duke theksuar se shpenzimin e energjisë elektrike nuk e ka bërë i padituri [REDACTED] por shfrytëzuesi [REDACTED] pronar i firmës [REDACTED] dhe i njëjti sa ka qenë duke shfrytëzuar lokalin asfarist si qiramarrës nuk e ka paguar shpenzimet e energjisë elektrike të shpenzuar dhe të njëjtin për këtë arsye edhe është larguar nga lokali afarist dhe nga shuma 7,032.82€, kam filluar ta paguaj dhe e kam zvogëluar deri me datën 20.05.2012 , ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta refuzon kërkesë padinë e paditësit të të pabazuar.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë ushtrimin e provave, lexohet fatura e dt.20.05.2012 kartela e të paditurit.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara konstatoi se ekziston detyrimi i të paditurit që paditëses t'i paguajë borxhin në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, meqë i padituri me kurrfarë prove nuk argumentoi të kundërtën.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga provat e administruara u vërtetua se i padituri i ka borxh paditëses shumë prej 5,478.09€, e cila shihet edhe nga transaksioni i konsumatorit e cila gjendet në shkresat e lëndës.



I autorizuari i e të paditurit në fjalën e tij se energjinë elektrike e ka shfrytëzuar [redacted] i cili ka qenë duke shfrytëzuar lokalin afarist me qira nuk e ka argumentuar me asnjë provë, nuk ia ka faluar besimin por edhe po të ishte ashtu i njëjti do të kishte lidhur kontratë me shkrim ku do të përcaktoheshin të drejtat dhe detyrimeve në mes palëve kontrakturës ndaj personave të tretë në këtë rast ndaj paditëses lidhur me pagesën e energjisë elektrike, por në rastin konkret paditësja ka kontratë për furnizim me energji elektrike me [redacted] dhe pagesën e energjisë elektrike e jo me personat e tjerë.

Nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës është e pakontestueshme se palët ndërgjyqëse janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete për furnizim, shfrytëzim të energjisë elektrike dhe pagesën e borxhit të shpenzuar të energjisë elektrike në kuptim të nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara-faturat.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 50 € dhe aktgjykim prej, 50 €, gjithësej në lartësi prej 100 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr. 433/12 më dt.11.02.2015



Gjyqtari:
Eriq Mehmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

